VENDIM
Nr. 844, datë 29.12.2021

PËR DHËNIE SHTESE PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR Z. ZHANI VASIL PETROPULLOS (ZIÇISHTI)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror z. Zhani Vasil Petropullos (Ziçishti), në masën e katërfishit të pensionit social, por shuma e pensionit, që përfiton sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë tetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama